



VENDIM

Nr. 116, datë 08.07.2016

MBI

**KËRKESËN E SHOQATËS SHQIPTARE TË ENERGJISË SË
RINOVUESHME PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 101 DATË
23.06.2016 TË BORDIT TË ERE “MBI MIRATIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE NË MODELIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SH.A. (FPSH) DHE
PRODHUESVE TË VEGJËL TË ENERGJISË (PVE) MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 80 DATE 23.10.2009, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 16, pika 4 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016 të Bordit të ERE, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.07.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi kërkesen e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme AREA, për rishikimin e Vendimit Nr. 101 datë 23.06.2016 të Bordit të ERE “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80 date 23.10.2009, të ndryshuar”

Konstatohet se:

- Shoqata AREA nuk përfaqëson palë interesi, të legjitimuar për të kërkuar rishikimin e një vendimi, akt-normativ, të Bordit të ERE.
- Nuk është provuar se cilet janë subjektet e licencuar nga ERE interesat e të cileve prezumohet se janë cenuar nga vendimmarrja e ERE.

- Nuk është paraqitur asnjë prove për të mbështetur kërkesën për rishikimin e Vendimit Nr. 101 datë 23.06.2016 të Bordit të ERE *“Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet kesh sh.a. (fjsh) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80 date 23.10.2009, te ndryshuar.”*
- ERE ka detyrimin të të zbatojë parashikimet e legjislacionit në fuqi, përfshirë ligjin 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjin 138/2013 “Për burimet e energjisë rinovueshme” dhe VKM 244 date 30.03.2016 *“Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rrezojë kërkesën e shoqatës shqipëtare të energjisë së rinovueshme AREA, për rishikimin e Vendimit Nr. 101 datë 23.06.2016 të Bordit të ERE *“Mbi miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet kesh sh.a. (fjsh) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80 date 23.10.2009, te ndryshuar”*
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI